A. Gllotmotina
09.08.2017

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta
Ministry of Culture, Youth and Sports
Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës Prizren
Prizren Institute for the Protection of Monuments
Nr. 191/4
Dt. 09.08.2017

# Republika e Kosovës

## Republika Kosova-Republic of Kosovo

*Qeveria -Vlada-Government*

*Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit -Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta-Ministry of Culture, Youth &Sports*

**Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore / Regionalni Centar za Kulturno Nasledje / Bölge Kültürel Miras Merkezi / Regional Center for Cultural Heritage**

**Prizren**

| | |
|---|---|
| DATË/A: | 09.08.2017 |
| REFERENC-Ë: | 191/4 |
| PËR/ZA/TO: | Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor |
| CC: | |
| PËRMES/PREKO/THROUGH: | |
| GA/OD/FROM: Për | Samir Hoxha - Drejtor i QRTK-së Prizren |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Rekomandimi i Komisionit të IKMM-së Prishtinë |

Po ju dërgojmë Rekomandimin e Komisionit të IKMM-së për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese-Konservuese të Trashëgimisë Kulturore nr.15/2017 të dt.10.07.2017 për lëndën e Ruzhdi Kasemllari Nr.04-353-57309

Lëndës ia bashkangjesim kopjen e Rekomandimit.

INSTITUTI I KOSOVËS PËR MBROJTJEN E MONUMENTEVE
INSTITUT ZA ZAŠTITU SPOMENIKA KULTURE KOSOVA
THE KOSOVO INSTITUTE FOR CULTURAL MONUMENT PROTECTION
Nr. 403 Dt. 08.08.2017
PRISHTINË

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit*
*Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta – Ministry of Culture, Youth and Sports*
Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve / Kosovo Institute for Protection of Monuments / Institut Kosova za Zastitu Spomenika

| | |
|---|---|
| DATË/A: | 10.07.2017 |
| REFERENC-Ë: | 15/2017 – Takimi i pesëmbëdhjetë |
| PËR/ZA/TO: | Z. Agim GËRGURI – U.D. Drejtor i Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve. |
| CC: | Z. Bislim BISLIMI – Udhëheqës i Divizionit për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit / DL – MKRS, anëtar i Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Projekteve dhe Kërkesave Restauruese Konservuese të Trashëgimisë Kulturore / IKMM;<br>Znj. Zana LLONÇARI OSMANI– Zyrtare e Lartë në Departamentin e Trashëgimisë Kulturore – MKRS, anëtare e Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Projekteve dhe Kërkesave Restauruese Konservuese të Trashëgimisë Kulturore / IKMM; |
| PËRMES/PREKO/THROUGH: | Znj. Teuta SELMANAJ – Zyrtare Ligjore në IKMM, përgjegjëse për mbështetjen administrative të punës së Komisionit. |
| NGA/OD/FROM: | Znj. Merita AUGUSTININRECAJ– Kryesuese e Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Projekteve dhe Kërkesave Restauruese Konservuese të Trashëgimisë Kulturore |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | *Rekomandimet e Komisionit, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të kërkesave / projekteve: Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore – Pejë dhePrizren.* |

I nderuar Drejtor z. Gërguri,

Komisioni për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Projekteve dhe Kërkesave Restauruese Konservuese të Trashëgimisë Kulturore (në tekstin e mëtejmë Komisioni) i emëruar me Vendimin Nr. 01/2016 të datës 13.04.2016,i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin tjetër Nr. 52/2016 të datës 04.10.2016 me Nr. të protokollit 376, i ndryshuar dhe plotësuar, ka zhvilluar takimin e pesëmbëdhjetë (15) punues me datë 28.06.2017, ku janë shqyrtuar kërkesat dhe projektet e Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturore (QRTK)-Pejë dhe Prizren. Janë dhënë rekomandimet si në vijim:

**Rreth kërkesës Nr. 1. QRTK – Prizren:**

1. Ruzhdi Kastenlari nga Prizreni ka parashtruar kërkesën për ndertimin e shtepisë individuale për banim në ngastrën kadastrale me numër 02200-0. Etazhiteti i objektit ekzistues është P+1, ndësa etazhiteti i ri parashihet të jetë B+P+1+NK. Objekti që do të ndertohet gjendet në znën e VI-të sipas planit të konservimit ku etazhiteti i lejuar është P+2 (lartësia maksimale deri te streha është 9.5 m) dhe për ndërtim mund të shfrytëzohet deri 60% e sipërfaqës së parcelës. Në afërsi të parcelës ku do te ndertohet objekti nuk ka ndonjë monument që gjindet në listën e MKRS.

Komisioni për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese – Konservuese të Trashëgimisë Kulturore / IKMM, pas shqyrtimit të lëndës/ projektit vërejti se kërkesa si e tillë nënkupton edhe aprovimin e rrënimit paraprak të objektit ekzistues si njësi/pjesë përbërëse Qendrës Historike të Prizrenit e mbrojtur me Ligjin për Qendrën Historike të Prizrenit e cila mbrohet si tërësi, dhe për rrjedhojë, refuzon projektin e paraqitur.
Komisioni, rekomandon QRTK –në të shpjegojë palës se intervenimet e lejuara në këtë kategori objektesh janë aplikimet plotësuese të cilat mundësojnë të ruajnë dhe mbrojnë karakterin e arkitekturës së mbrojtur sipas kritereve të përcaktuara në Planin e Konservimit dhe Zhvillimit të Qendrës Historike të Prizrenit.